



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 272, datë 28.12.2020**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR  
LLOGARITJEN E DETYRIMIT TË ENERGJISË SË RINOVUESHME DHE  
PROCEDURËN PER KOMPENSIMIN E PRODHUESVE ME PËRPARËSI TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 19, gërma “b” dhe 20, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 11, pika 3, të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/15 Prot, datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

**Konstatoi se:**

- ERE në bazë të detyrimeve që rrjedhin prej Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, përcaktohet si Autoriteti përgjegjës për miratimin e Rregullores për detyrimin për energjinë e rinovueshme që do të paguhet nga ana e klientëve fundorë të energjisë elektrike në një bazë vjetore dhe metodologjinë për përcaktimin e këtij detyrimi, si dhe procedurën e kompensimit të diferencës për prodhuesit.
- Draft-metodologjia e hartuar “Mbi metodologjinë për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, ka si qëllim përcaktimin e llogaritjes së detyrimit të energjisë së rinovueshme që u ngarkohet të gjithë klientëve fundorë nga furnizuesit e energjisë elektrike, si dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi nga Operatori i Energjisë së Rinovueshme për nxitjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.
- Draft-metodologjia përcakton gjithashtu, llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme, ku përcaktohet se ERE do të llogarisë vlerën e detyrimit të energjisë së rinovueshme në lekë/kWh, të ngarkuar për të gjithë klientët fundorë në përputhje me sasinë përkatëse të energjisë elektrike të matur dhe furnizuar nga furnizuesit te këta klientë fundorë.

Formula llogaritëse për përcaktimin e këtij detyrimi do të jetë:

***Detyrimi i BRE [Lek/kWh] = (Prodhimi total i energjisë elektrike nga BRE \* bonus [Lek / kWh]) / (Parashikimi i përgjithshëm i kërkesës së brendshme për energji elektrike [kWh])***

- Sa i përket rregullimeve të detyrimit të energjisë së rinovueshme, draft-metodologjia përcakton, se çdo vit ERE do të llogarisë diferencat midis vlerave dhe shumave të parashikuara dhe atyre të arritura për nxitjen e energjisë nga burimet e rinovueshme gjatë vitit të kaluar kalendarik si dhe rezultatet do të publikohen për të gjithë palët e interesuara dhe do të përfshihen në rishikimin e detyrimit të energjisë së rinovueshme në periudhën e ardhshme rregullatore.
- Lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes palëve, draft-metodologjia përcakton rolin e ERE-s si autoritet përgjegjës për zgjidhjen e tyre sipas dispozitave të parashikuara në Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe “Rregullores për Trajtimin e Ankesave të Paraqitura nga Klientët dhe për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve midis të Licencuarve, në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 114, datë 8.7.2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për miratimin e draft-metodologjisë për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**